

## Thirrje për fermerë për Certifikim me standardin GLOBAL GAP

Shoqata Nacionale “Mjedra e Kosovës” ka kënaqësinë të shpallë thirrje për fermerët e interesuar për certifikimin me standardin GLOBAL GAP. Kjo nismë do të realizohet në kuadër të projektit EREA, i cili financohet nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe implmentohet nga CARITASI Zvicerian. Qëllimi i këtij aktiviteti synon rritjen e kapaciteteve të fermerëve për të përmbushur standardet e sigurisë ushqimore dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm brenda komunitetit rural.

### Objektivi i aktivitetit:

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti certifikues është të rrisë ndërgjegjësimin dhe të përmirësoj praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm, ekonomik, social dhe mjedisor tek fermerët e sektorit të mjedres. Duke arritur certifikimin GLOBAL GAP, fermerët mund të përmirësojnë praktikën e tyre bujqësore, të rrisin qasjen në treg dhe të kontribuojnë në përmirësimin e përgjithshëm të standardeve të sigurisë ushqimore.

### Kush mund të aplikojë:

Të gjithë fermerët në Kosovë të sektorit të mjedres kanë të drejtë aplikimi. Fermerët të cilët janë të përkushtuar në adoptimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe përmbushjen e kërkesave të standardit GLOBAL GAP inkurajohen të aplikojnë.

### Përfitimet e Certifikimit:

Përmes implementimit të këtij aktiviteti synohen të përmirësohet:

- Rritja e qasjes në treg dhe konkurrueshmërisë;
- Përmirësimi i efikasitetit dhe produktivitetit;
- Respektimi i standardeve ndërkombëtare të sigurisë ushqimore;
- Njohja për praktikën e qëndrueshme bujqësore.

### Procesi i aplikimit:

Fermerët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikacionet e tyre në e-mailin [info@mjedraekosoves.com](mailto:info@mjedraekosoves.com) deri më 28.03.2024. Aplikimet duhet të përfshijnë një përmbledhje të shkurtër të fermës (emri dhe mbiemri i fermerit, sipëraqja e kultivuar, variteti i kultivuar dhe lokacioni i pemishtës), si dhe një përshkrim i shkurtër për praktikën aktuale të kultivimit.

### Procesi i certifikimit:

Fermerët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen trajnimeve dhe vlerësimit për të përmbushur kërkesat e standardit GLOBAL GAP. Procesi i certifikimit do të kryhet nga trupa certifikuese të akredituara dhe shpenzimet do të mbulohen nga Shoqata Nacionale “Mjedra e Kosovës”.

Për më shumë informacione lidhur me procesin e implementimit të standardit ose për ndonjë paqartësi, ju lutemi kontaktoni Kujtim Lepaja në e-mailin [kujtim.lepaja@mjedraekosoves.com](mailto:kujtim.lepaja@mjedraekosoves.com) dhe Lindita Ibishi në e-mailin [lindita.ibishi@mjedraekosoves.com](mailto:lindita.ibishi@mjedraekosoves.com)